

## NË EMËR TË POPULLIT

**P.nr.379/2016**

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË**, Gjyqtari Qemail Suka, me Bash. Prof. Haxhi Hoti, në lëndën penale kundër të akuzuarit H. D. N., nga fsh.M., Komuna e Suharekës për shkak të veprave penale, lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par.1.4, të KP-së, duke vendosur sipas Aktakuzës të PTH në Prizren PP/nr.1873/2015, të dt. 12.05.2016, në shqyrtimin fillestar, në prezencën e PSH. Musli Gashi, dhe të akuzuait, me dt, 15.02.2018, morri dhe publikisht shpalli dhe me datë 23.02.2018 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I Auzuari** H. N. nga i ati D., e ëma A. e lindur D., i lindur me dt. 15.02.1974 , nga fsh. M., me numer personal ....., ka te kryer shkollen fillore, i pa pune, i martuar, baba i katër (4) femijëve, i gjendjes jo të mire ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

### **ËSHTË FAJTOR**

I. Sepse me dt. 04.06.2015 rreth ores 18.00 ne fshatin M. Komuna e Suharekes i shkakton lendime te lehta trupore te demtuarit N. A. qe rezulton me pasoja te perkohshme ne shendet ne ate menyre qe i demtuari bagetit te cilat i ruante janë bashkuar me bagëtit e te pandehurit, i pandehuri e godet ne pjese te ndryshme te trupit, duke i shkaktuar lendime te lehta trupore dhe ate lezin (i paspecifikuar) traumatik ne regjionin gluteal te majte.

- Me këtë ka kryer veprën penale, lëndimi i lehtë trupor nga, neni 188 par.1. nën par.1.4, të KP-së.

II. Se me dt. 04.06.2015 rreth ores 18.30 minuta, ne fshatin M. Komuna e Suharekes, i shakton lendime te lehta trupore te demtuarit Rr. A. qe rezulton me pasoja te perkohshme ne shendet, ne ate menyre qe per shkak te rrahjes te pershkruar sine dispozitivin e pare, i demtuari Rr. A., shkon ne shtepin e te pandehurit per te sqaruar i pandehuri e godet me grushte ne fytyre duke i shkaktuar lendime te lehta trupore dhe ate, ajtje dhe skuqje ne regjionin per rreth orbites se syrit te majte.

- Me këtë ka kryer veprën penale, lëndimi i lehtë trupor nga, neni 188 par.1. nën par.1.4, të KP-së.

Gjykata në kuptim të nenit 41, 43, 46, 51, 52, 73, 74, si dhe nenit 188 par.1., nën par.1.4, të KP-së. i shqipton:

### **DENIM ME KUSHT**

**Për veprën penale** sipas dispozitivit nën I të aktakuzës ia cakton denimin me burgim prej 2 (dy) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin e verifikimit prej një viti nëse i akuzuari nuk kryen vepra tjera penale.

Sipas dispozitivit nën II të aktakuzës ia cakton denimin me burgim prej 2 (dy) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin e verifikimit prej një viti nëse i akuzuari nuk kryen vepra tjera penale.

Në kuptim të nenit 80 të KP-së. Gjykata i shqipton:

### **DËNIMIN UNIK**

Duke ia caktuar dënimin prej tre (3) muajve burgim i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afatin e verifikimit prej një viti nuk kryen vepra tjera penale.

Obligohet i akuzuari që në emër të ekspertizës mjeko- ligjore të paguaj në shumën prej 20 euro, si dhe paushallin gjyqsor në shumën prej 20 euro pas plotëfuqishmëris së këtij aktgjykimi.

Udhëzohet pala e dëmtuar që kërkesën pasurore-juridike ta realizoi në kontest të rregullt civil.

### **A r s y e t i m**

PTH. nga Prizreni me aktakuzën PP/II nr. 1873/2015, të dt. 12.05.2016, ka akuzuar H. N., nga fsh. M. Komuna e Suharekës, për veprën penale, lëndim i lehtë trupor nga, neni 188 par.1, nën par.1.4 të KP-së.

Aktakuzën të cilën gjatë seances së shqyrtimit fillestar prej fillimi e gjer në mbarim e ka përfaqësuar PSH. Në Prizren Musli Gashi, i cili në terësi ngel pran të dhënave si në aktakuzë që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit. Gjykata në shqyrtimin fillestar të mbajtur me dt.15.02.2018, edhe nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari ka konstatuar këtë gjendje faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këtë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar nga i akuzuar i cili në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë.

Gjykata sipas detyrës zyrtare konform nenit 257 të KPP-së në shkresat e lëndës nuk gjeti ndonjë provë të pa pranueshme dhe po ashtu ka vërtetuar se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë vullnetarisht në shqyrtimin fillestar, pranimi është mbështetur në faktet e qështjes që përmban aktakuza siq janë.

Kallximi penal nr.2015-GB-4.. të dt.24.06.2015. si dhe deklarata e të dëmtuarit dhënë në polici me dt. 04.06.2015, mendimin e ekspertit mjeko- ligjor Dr. M. G. të dt.28.07.2015, ndaj të akuzuarit nga ana e PTH-së në Prizren.

Gjykata po ashtu në terësi ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë në shqyrtim fillestar nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me dispozitat e nenit 248 të KPP-së. Nga se nuk ekziston ndonjë nga arsyerat dhe kushtet për hudhjen e aktakuzës, apo pushimin e procedurës penale.

Dhe nga këto fakte të cilat i përmban aktakuza, gjykata ka ardhur në përfundim se me veprimet e të akuzuarit, formohen të gjitha elementet e veprës penale, lëndim i lehtë trupor nga, neni 188 par.1, nën par.1.4 , të KP-së.

Andaj gjykata ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe të i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin ka vlerësuar të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KP-së, të cilat ndikojnë në lartësin e dënimit.

Gjykata si rrethanë lehtësuese muarr për bazë se i akuzuari ka pasur qëndrim korrekt ndaj gjykatës, ka bërë pranimin e fajësisë në mënyrë vullnetare është penduar për veprën e kryer, është hera e parë që bien ndesh me ligjin, kurse rrethana posaqërisht rënduese nuk gjeti.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës u muarr në kuptim të nenit 453 l të KPP-së.

Vendimi mbi kërkesën pasurore- juridike u muarr në kuptim të nenit 463 të KPP-së.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN- DEGA NË SUHAREKË,**

**P. nr.379/2016, dt. 23.02.2018**

**Bash. Prof.  
Haxhi Hoti**

**Gjyqtari  
Qemal Suka**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pa knaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 15 dite, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.